

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË NJËSINË E MBIKËQYRJES SË LOJRAVE TË FATIT, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Njësinë e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Tiranë me objekt “Mbi zbatimin e procedurave të licencimit, mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së subjekteve, që organizojnë lojëra fati, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, në përputhje me legjisllacionin për këtë veprimtari dhe aktet nënligjore në fuqi” për periudhën 01.01.2013 – 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 40, datë 31.03.2015.

Bazuar në nenet 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 1207/7, datë 07.04.2015, për zj. Luneda Sufali me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe shkresën nr. 1207, datë 07.04.2015, për z. Shkëqim Cani, Ministër i Financave, i janë dërguar “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIME LIGJORE

1. Në ligjin nr. 10033, datë 11.12.2008 “Për Lojërat e Fatit” me ndryshime neni 20 “Rregullorja e lojës për bastet”, përcaktohen kriteret që duhet të plotësojë Rregullorja e lojës për bastet.

Sipas nenit 23 “Kriteret e lejimit për zhvillimin e lojës “Kazino elektronike” pika 1, germa (dh) dhe neni 41 “Kriteret e lejimit për organizimin e bingos tradicionale dhe të bingos televizive” pika 1, germa (dh), thuhet se, organizatori i lojërave të fatit “të paraqesë rregulloren e lojës, sipas nenit 20 të këtij ligji, “Rregullorja e lojës për bastet”. Për këtë është rekomanduar shtimi i 2 (dy) neneve të veçanta në Kreun IV “Organizimi i lojërave të fatit “Kazino elektronike” dhe Kreu VII “Organizimi i Bingove televizive dhe tradicionale”, për kriteret që duhet të plotësojë “Rregullorja e lojës” për secilën nga këto kategori lojërash fati, pasi kriteret që duhet të plotësojnë nuk janë tërësisht të njëjta.

2. Në ligjin nr. 10033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit” me ndryshime, neni 23 “Kriteret e lejimit për zhvillimin e lojës “Kazino elektronike”, pika 1, germa (gj) thuhet se: “Organizatori duhet të paraqesë dokumentin e certifikimit të mjeteve elektronike, në përputhje me nenin 24 të këtij ligji germa (f) që thotë: “makinat duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe të certifikuar, në përputhje me nenin 25 të këtij ligji që thotë: “Asnjë shoqëri nuk mund të vendosë apo të ofrojë lojëra sipas konceptit/funksionimit të VLT-së, deri në çastin që VLT-ja të certifikohet dhe të miratohet nga NJMLF në bashkëpunim me Drejtorinë e Akreditimit, e cila afishon në një vend të dukshëm, kërkesat sipas pikës 5 të këtij neni”.

Për sa i përket termit “certifikim nga NJMLF”, përdorur nenin 25 sqarojmë se, NJMLF nuk mundet teknikisht dhe ligjrisht të kryejë certifikim të makinerive të lojërave të fatit për arsye se nuk është i njohur ligjrisht si Organizëm i Vlerësimit të Konformitetit, i akredituar nga institucionet përkatëse të akreditimit, si dhe nuk ka mjete teknike për kryerjen e këtij funksioni (labororë testues). Gjithashtu, as Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nuk kryen testime të kësaj natyre. Aktualisht procedura që kryen NJMLF-ja është kontroll përputhshmërie mbi plotësimin e specifikimeve teknike të makinave të përshkruara në raport testet e lëshuara nga

laboratorët testues jashtë vendit me gjendjen fizike të makinave elektronike të paraqitura nga organizatori i lojërave të fatit sipas tipit dhe numrave serialë. Për këtë është rekomanduar saktësimi i terminologjisë së përdorur, zëvendësimin e “certifikimit” me “verifikim/kontroll”.

3. Në udhëzimin nr. 46, datë 13.11.2009 “Për përcaktimin e procedurave për konfiskimin, magazinimin dhe shkatërrimin e mjeteve të lojërave të aftit”, pika 4 thuhet: “Të gjitha mjetet e konfiskuara të lojërave të fatit makineri elektronike dhe aparatat e bingos, brenda jo më shumë se 60 ditëve nga data e sekuestrimit, i nënshtrohen procedurës së shkatërrimit”. Nga auditimi është konstatuar se ky afat nuk është respektuar asnjëherë, për arsye se NJMLF nuk ka kapacitetet e duhura që për çdo 60 ditë, të ngrëjë komisionet përkatëse, të inventarizimit, shkatërrimit, asgjësimit, por edhe të kryerjes së procedurave të tjera mbi shkatërrimin, asgjësimin dhe trajtimin e mbetjeve. Për këtë është rekomanduar që:

3.1. Pika 4 të bëhet: “Për shkatërrimin e mjeteve të konfiskuara, makineri elektronike, tavolina pokeri, aparatat e bingos dhe garat me qen, NJMLF të ngrëjë komisionin për shkatërrimin e tyre 4 herë në vit”.

3.2. Pikë shtesë në udhëzimin nr. 46, datë 13.11.2009, ku të përcaktohet mënyra e ngritjes së komisioneve të inventarizim/vlerësimit, nxjerrjes jashtë përdorimit dhe komisionet e shkatërrimit, referuar udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3.3. Pikë shtesë në udhëzimin nr. 46, datë 13.11.2009, ku të përcaktohet se për procesin dhe mënyrën e shkatërrimit të mjeteve të konfiskuara, NJMLF duhet të zbatojë Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

4. Në ligjin nr. 10033, datë 11.12.2008 “Për Lojërat e Fatit” në nenin 47 “Masa administrative”, pika 5, nuk është parashikuar gjobë për subjektet që zhvillojnë lojëra fati “promocionale” pa miratim të Ministrisë së Financave. Për këtë është rekomanduar që në nenin 47 “Masa administrative”, pika 5 të shtohet një germë mbi nivelin e gjobës në rast të zhvillimit të lojërave promocionale pa miratim të Ministrisë së Financave.

5. Nga auditimi janë konstatuar raste kur subjektet nuk paguajnë detyrimet sipas afateve të përcaktuara në udhëzimin nr. 47, datë 26.11.2009 “Për mënyrën dhe afatet e kryerjes së detyrimeve ligjore të subjekteve të miratuara dhe të licencuara në fushën e lojërave të fatit” dhe për këtë shkelje nuk është parashikuar penaltitet ndaj subjekteve. Për këtë është rekomanduar që të formulohet pikë shtesë në udhëzimin nr. 47, datë 26.11.2009 “Për mënyrën dhe afatet e kryerjes së detyrimeve ligjore të subjekteve të miratuara dhe të licencuara në fushën e lojërave të fatit” ku të parashikohet vendosja e një penaltiteti nga NJMLF-ja, për derdhjen me vonesë të detyrimeve nga subjektet.

6. Në ligjin nr. 10033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, me ndryshime neni 44 “Detyrimet tatimore”, pika 5.2, “Basteve sportive” shprehet se: “Brenda datës 10 të muajit pasardhës, organizatori i lojërave të fatit derdh në llogari të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve 0,2 për qind të shumave të grumbulluara, në përputhje me këtë nen, për zhvillimin e sporteve”. Nga auditimi u konstatua se neni 44, nuk ka gjetur zbatim nga kompanitë e basteve sportive, si dhe, nga NJMLF, nuk është mbikëqyrur zbatimi i këtij detyrimi nga kompanitë. Për këtë është rekomanduar që nga Ministria e Financave të nxirret udhëzim i përbashkët midis

NJMLF dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, në zbatim të nenit nr. 44, pika 5.2 të ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008 “Për Lojërat e Fatit”, ku të përcaktohet mënyra e rakordimit dhe përgjegjësitë e palëve për vjeljen e këtij detyrimi të kompanive të “Basteve sportive”, konkretisht:

-NJMLF, duhet të informojë Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, mbi subjektet që zhvillojnë veprimtari në fushën e lojërave të fatit “Baste sportive”, të cilët kanë si detyrim ligjor derdhjen e detyrimit (0.2% të shumave të grumbulluara).

-Ministria e Arsimit dhe Sporteve, duhet që çdo muaj të informojë NJMLF, për subjektet të cilat nuk kanë shlyer këtë detyrim (çdo datë 10 të muajit pasardhës), me qëllim vendosjen e penaliteteve dhe marrjen e masave shtrënguese ndaj tyre.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga NJMLF është ndryshuar programi i ruajtjes së të dhënave i regjistrit elektronik mbi aktivitetin e subjekteve që operojnë në fushën e lojërave të fatit, por nuk është bërë përditësimi i të dhënave të subjekteve, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 26-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që nga NJMLF, të merren masa për përditësimin e të dhënave të regjistrit elektronik. Ky përditësim duhet të rregullohet në një afat, limiti kohor dhe të përfshihet në rregulloren e funksionimit të Drejtorisë së IT.

Brenda 6-muajve

2. Nga auditimi i regjistrit të të dhënave u konstatua se ndërfaqja e sistemit elektronik të regjistrit është disenjuar që më shumë të ofrojë informacion për gjendjen aktuale të subjektit se sa për historikun e tij. Një ndërfaqe që ofron të dhëna për historikun e aktivitetit të subjektit do të shërbejë më mirë nevojave të kontrollorëve të Drejtorisë së Kontrollit dhe Masave Shtrënguese, duke qenë se zakonisht kontrollohen periudha kohe dhe jo gjendje të momentit në subjekt, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 26-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që nga NJMLF, të merren masa për përmirësimin e programit, duke marrë nga secila drejtori e NJMLF-së, kërkesat për këto përmirësime, në mënyrë që regjistri të shërbejë sa më mirë kryerjes së funksioneve, nëpërmjet ofrimit të më shumë ndërfaqeve të historikut të evolucionit të të dhënave, krahas përditësimin të të dhënave më të fundit.

Brenda 6-muajve

3. Nga krahasimi i regjistrit të të dhënave me të dhënat e evidentuara nga auditimi i ri/certifikimit të pajisjeve, nga Drejtoria e Certifikimit, u konstatuan diferenca. Ndonëse është kryer procesi i ri/certifikimit, nga Drejtoria e Certifikimit, nuk është kryer asnjë verifikim i pasqyrimin të këtyre të dhënave në sistem, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 26-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që nga Drejtoria e Certifikimit të kryhet verifikimi i të dhënave të hedhura në sistem mbi datat e certifikimeve të fundit të kryera dhe për këtë të raportohet Drejtores së NJMLF-së. Më tej, nga kjo drejtori, ky proces të ushtrohet në baza periodike.

Deri në Korrik 2015

4. Nga auditimi i praktikës së ri/certifikimit të kryer nga Drejtoria e Certifikimit vihet re se kontrollat në subjekt kryhen vetëm bazuar në kërkesat e subjekteve për ri/certifikim, ndonëse disponohet regjistri elektronik i të dhënave mbi datën më të fundit të ri/certifikimeve të kryera,

trajtuar më hollësisht në faqet nr. 27-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar që nga Drejtoria e Certifikimit të aplikohet praktika e kryerjes së kontrolleve në subjekte mbi certifikimin e pajisjeve të subjekteve, jo vetëm duke u bazuar në kërkesat që bëjnë vetë subjektet, por duke u bazuar edhe në verifikimin e të dhënave të regjistrit.

Në vazhdimësi

5. Nga auditimi i ushtruar lidhur me rregullshmërinë e ushtrimit të aktivitetit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e lojërave të fatit për pikën e punonjësve, vihet re se në disa raste ka kazino që ushtrojnë aktivitet me një punonjës dhe me mbi 10 pajisje për njësi. Ndonëse numri minimal i punonjësve për pikë nuk është një kërkesë e ligjit, ky fakt përbën risk për situatat ku nuk është bërë deklarimi i numrit real të punonjësve dhe për pasojë mundësi për parregullsi në funksionim të subjektit që ushtron aktivitet në fushën e lojërave të fatit, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 27-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.* Për këtë është rekomanduar që nga Drejtoria Operacionale të përfshihen në formulën e përzgjedhjes për kontroll, subjektet që ushtrojnë aktivitet me një punonjës, duke vlerësuar një nivel të riskut specifik minimal, të nevojshëm për inicimin e kontrolleve të menjëhershme në këto pika.

Në vazhdimësi

6. Nga auditimi është konstatuar se rakordimi ndërmjet NJMLF dhe DPT, në zbatim të nenit 50 pika 2, është bërë në të gjitha rastet me vonesë, si dhe përgjigja e DPT dhe degëve të saj është përsëri me vonesë, ose nuk ka kthim përgjigjeje në të shumtën e rasteve.

-Mos dorëzimi "Formular i Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi Lojërat e Fatit" në mënyrë të rregullt periodikisht; rakordimi i Deklarimeve Mujore me DPT e degët e saj, sipas dispozitës ligjore, bën të pamundur krahasimin e të dhënave të NJMLF-së me vetëdeklarimet e subjekteve.

-Vlera e saktë e shumës së paguar nga subjektet verifikohet në bazë të "Formulari i Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi Lojërat e Fatit" dhe shmangiet nga pagesa reale bëhen në kohë nëse këto formularë dorëzohen pranë NJMLF-së, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 37-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.* Për këtë është rekomanduar që NJMLF të rrisë bashkëpunimin me DPT, për sa i përket rakordimit të NJMLF-së me DPT në lidhje me deklarimet mujore, pasi kjo bën të mundur evitimin e shmangieve nga pagesat reale të detyrimit dhe kryerjen e pagesave në kohë.

Në vazhdimësi

7. Nga KLSH është konstatuar se subjektet kanë një borxh të mbartur ndaj NJMLF, i përbërë kryesisht nga mos derdhja e detyrimit 0.5 % të xhiros dhe nga vlera e gjobave të pa arkëtuara. Nga NJMLF nuk janë zbatuar të gjitha masat shtrënguese që përcaktohen në nenin 53 dhe 55 të ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008 me ndryshime "Për Lojërat e fatit", si dhe nuk janë bërë përpjekjet e duhura në lidhje me kërkesat dhe ri kërkesat që duhet t'ju drejtojnë institucioneve të treta që vijnë në ndihmë për vjeljen e borxhit, *trajtuar më hollësisht në faqen nr. 31-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.* Për këtë është rekomanduar që nga NJMLF të merren masat e menjëhershme për zbatimin e masave shtrënguese të përcaktuara në nenin 53 dhe 55 të ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008 "Për Lojërat e fatit" me ndryshime, si dhe të rritet bashkëpunimi me ZVRPP dhe DPSHTRR, si institucione të ngarkuara me ligj për bashkëpunim me NJMLF për arkëtimin e borxhit nga subjektet debitorë.

Menjëherë

8. Nga auditimi është konstatuar se nga NJMLF, në procedurat e ndjekura për miratimin e lejeve të subjekteve për ushtrim veprimtarie në fushën e lojërave të fatit, nuk është bërë miratimi i Rregullores së Lojës, të propozuar nga subjektet të cilat aplikojnë për marrjen e lejeve, në kundërshtim me ligjin nr. 10033, datë 11.12.2008 me ndryshime, nenin 20, ku thuhet: “Rregullorja e lojës së fatit propozohet nga organizatori dhe miratohet nga NJMLF-ja, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 19-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që nga NJMLF, të merren masa të menjëhershme që në zbatim të ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008 me ndryshime, nenin 20, ku thuhet: “Rregullorja e lojës së fatit propozohet nga organizatori dhe miratohet nga NJMLF-ja”, të përcaktojë formularin e miratimit të rregulloreve të lojërave të fatit të paraqitura nga organizatorët dhe të bëjë miratimin e rregullores para miratimit të lejeve për ushtrim veprimtarie.

Menjëherë

9. Nga auditimi është konstatuar se, nga NJMLF, nuk janë lëshuar Çertifikata për miratimin e Makinave Elektronike, për subjektet të cilat kanë aplikuar për miratim leje për ushtrim veprimtarie në fushën e lojërave të fatit, në kundërshtim me ligjin nr. 10033, datë 11.12.2008 me ndryshime, nenet 23, 24, dhe 25, ku kërkohet Certifikimi i tyre dhe konfirmimi i plotësimit të specifikimeve teknike të makinave elektronike, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 19-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që, nga NJMLF, të merren masa të menjëhershme që në zbatim të ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008 me ndryshime, nenet 23, 24 dhe 25, të konfirmojë plotësimin e specifikimeve teknike të makinave elektronike, para miratimit të kërkesës së subjekteve për ushtrim veprimtarie në fushën e lojërave të fatit.

Menjëherë

10. Nga auditimi është konstatuar se NJMLF, gjatë procedurave për shkatërrimin e makinave elektronike, konkretisht për përbërjen e Komisioneve të Inventarizim/vlerësimit; Komisioneve të nxjerrjes jashtë përdorimit dhe Komisioneve të shkatërrimit, në disa raste ka në përbërjen e tyre të njëjtët persona, veprim në kundërshtim me udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 40-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që, nga titullari i NJMLF, të merren masa për ngritjen e komisioneve të inventarizim/vlerësimit, komisioneve të nxjerrjes jashtë përdorimi dhe atyre të shkatërrimit, në përputhje me kërkesat e udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

11. Nga auditimi është konstatuar se gjatë vitit 2013, nga grupet e kontrollit, në përfundim të punës në terren, në aktkonstatimet e mbajtura në subjektet e kontrolluara, në të cilët është konstatuar se kanë ushtruar veprimtari pa leje dhe për rrjedhojë ju konfiskohen pajisjet e gjetura, nuk është bërë përshkrimi i tyre, sasia e gjetur, tipi i makinave dhe numri serial i tyre, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 49-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që të merren masa të menjëhershme që nga grupet e kontrollit në aktkonstatimet e mbajtura në subjekte, në rastet e konstatimit të ushtrimit të veprimtarisë pa leje dhe gjetjes së mjeteve të pa licencuara, të përshkruhet numri, tipi dhe numrat serialë të tyre. Mënyra e

plotësimit të aktkonstatimeve për këto raste të përcaktohet në Rregulloren e brendshme të NJMLF-së, neni 35 “Kontrolli në subjekte”.

Menjëherë

12. Nga auditimi është konstatuar se nga NJMLF, nuk është implementuar ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, sipas Manualit për MFK-në, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Janë konstatuar mangësi në evidentimin, kryerjen e kontrolleve shtesë për minimizimin e tij dhe monitorimin e riskut, plotësimin e regjistrit të riskut, pyetësorit të vetëvlerësimit, hartimin e gjurmës së auditimit etj., *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 59-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që nga titullari i NJMLF, në cilësinë e nëpunësit autorizues, të merren masa të menjëhershme, për implementimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Manualin për MFK-në, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij.

Menjëherë

13. Nga auditimi është konstatuar se nga NJMLF, për subjektet që ushtrojnë veprimtari të pamiratuara, në kundërshtim me ligjin nr. 10033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit” me ndryshime, nuk është aplikuar gjobë respektive sipas nenit nr. 47, pika 5 të ligjit, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 49-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që nga NJMLF të merren masa të menjëhershme, për ngritjen e një komisioni i cili të marrë në shqyrtim dhe të vendosë gjobat në zbatim të ligjit nr. 10033 datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit” me ndryshime, neni 47 “Kundërvajtjet administrative”, në vlerën totale prej **143,500,000 lekë** për rastet e mëposhtme:

13/1. Vendosjen e gjobave në vlerën **4,500,000 lekë**, ndaj 9 subjekteve, të cilat nuk kanë derdhur minimumin ligjor në masën 0,5 %, të xhiros si detyrim ndaj NJMLF-së, në zbatim të nenit 12 të ligjit, gjobë në masën 500,000 lekë mbështetur në nenin 47 “Kundërvajtjet administrative”, pika 1, germa (f), të ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit” me ndryshime, për subjektet sipas aneksit nr. 1 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

13/2. Vendosjen e gjobave në zbatim të nenit 47 “Kundërvajtjet administrative”, pika 5, të ligjit nr. 10033 datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit” me ndryshime, për subjektin “████████” sh.a. me NIPT-████████, në masën 500,000 lekë për çdo makineri, në total $175 \times 500,000 = 87,500,000$ lekë.

Menjëherë

13/3. Vendosjen e gjobave në zbatim të nenit 47 “Kundërvajtjet administrative”, pika 5, të ligjit nr. 10033 datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit” me ndryshime, për subjektin “████████” sha, kategoria “Bingo tradicionale”, me NIPT ██████████, të aplikohet gjobë për zhvillim aktiviteti të palicencuar në masën **30,000,000 lekë**.

Menjëherë

13/4. Vendosjen e gjobave në masën 500,000 lekë mbështetur në nenin 47 “Kundërvajtjet administrative”, pika 1, germa (f), të ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit” me ndryshime ndaj subjekteve, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet e tyre që rrjedh nga zbatimi i nenit 44, pika 5.2 e ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008 me ndryshime, detyrimin që organizatorët

e lojërave të fatit “Baste sportive” kanë kundrejt Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve (Ministria e Arsimit dhe Sporteve), në shumën totale **21,500,000 lekë** për 13 subjektet sipas aneksit nr. 2, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga NJMLF të merren masa të menjëhershme ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për vjeljen e detyrimeve të pashlyera në shumën prej **58,112,287 lekë**, nga subjektet që operojnë në fushën e lojërave të fatit, si më poshtë:

1. Vlera prej **23,728,414 lekë**, nga 13 subjektet sipas aneksit nr. 3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, për detyrim të pa derdhur (0,2 % e shumës së grumbulluar) nga kompanitë e basteve sportive, për llogari të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve (Ministria e Arsimit dhe Sporteve), për periudhën 2009-2013, *(trajtuar në faqet 49-59, Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Menjëherë

2. Vlera prej **34,383,873 lekë**, nga 28 subjektet sipas aneksit nr. 4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, për detyrim të pa derdhur në masën 0,5 % e xhiros së kompanive të lojërave të fatit, ndaj NJMLF-së, *(trajtuar në faqet 31-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i është rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Njësisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, që në vlerësim të shkeljeve të evidentuara dhe personave përgjegjës përkatës, të bëjë klasifikimin e tyre dhe të marrë masat disiplinore sipas VKM nr. 115, datë 05.03.2014 dhe ligjit nr. 152/2013, nga “vërejtje” deri në “largim nga detyra”, për nëpunësit civil të NJMLF-së si më poshtë:

1. Znj. ██████████, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve.
Për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshime dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pasi nuk ka zbatuar procedurat ligjore për shkatërrimin e mjeteve të konfiskuara të lojërave të fatit.
2. Z. ██████████, me detyrë Inspektor Kontrolli.
3. Z. ██████████, me detyrë Inspektor Kontrolli.
4. Z. ██████████, me detyrë Inspektor Kontrolli.
5. Znj. ██████████, me detyrë Inspektore Kontrolli.
6. Znj. ██████████, me detyrë Inspektore Kontrolli.

Për veprime në kundërshtim me nenin 47, pikën 4 të ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit” me ndryshime dhe Rregulloren e Brendshme të NJMLF-së, pasi nuk kanë aplikuar gjobë ndaj subjekteve “██████████”sha dhe “██████████” sha.

Për punonjësit:

1. Zj. ██████████, me detyrë Drejtoresë e Drejtorisë së Certifikimit
2. Z. ██████████, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit dhe Masave Shtrënguese
3. Z. ██████████, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit

të cilët janë atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për mangësi në zbatimin e detyrave funksionale, por që nuk kanë sjellë pasoja dhe nuk janë të përsëritura, nuk është rekomanduar masë disiplinore.

Ndersa për punonjësit e poshtëshënuar:

1. Z. ██████████, me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm dhe Drejtorie
2. Z. ██████████, me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Licencimit
3. Z. ██████████, me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Licencimit
4. Z. ██████████, me detyrë ish inspektor kontrolli
5. Z. ██████████, me detyrë ish inspektor kontrolli
6. Z. ██████████, me detyrë ish inspektor kontrolli
7. Z. ██████████, me detyrë ish inspektor kontrolli
8. Z. ██████████, me detyrë ish inspektor kontrolli
9. Z. ██████████, me detyrë ish inspektor kontrolli
10. Z. ██████████, me detyrë ish inspektor kontrolli
11. Z. ██████████, me detyrë ish inspektor kontrolli
12. Z. ██████████, me detyrë ish inspektor kontrolli

nuk është rekomanduar masë disiplinore, për arsye se kanë shkëputur marrëdhëniet me institucionin.

Shënim: Auditimi u krye përgjatë periudhës 06.01.2015 deri më 23.02.2015, nga audituesit Brunilda Zeneli, p/grupi, Edvin Stefani, Anesti Gjika Joniada Goçaj, u mbikëqyr nga Kryeauditues z. Albert Thoma, më tej u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit zj. Albana Agolli dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

NJMLF ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme me shkresë nr. 1207/9, datë 21.04.2015 ku me urdhrin nr. 239, datë 16.04.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, është ngritur një grup pune për shqyrtimin e rekomandimeve të KLSH dhe hartimin e planit të punës për zbatimin e tyre.

NJMLF, në bazë të përgjigjes së mësipërme, do të njoftojë KLSH në vijimësi për ecurinë e realizimit të secilit rekomandim.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT